



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh. II.nr.1646/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “NT “Abetarja”, me seli në adresën rr. “15 Qershori” në Gjilan, me nr. të unik identifikues 810263880, kundër debitorit Komuna e Novobërdës-Drejtoria e Arsimit, Sh.F.M.U “Asdreni”, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1810/22 të datës 26.09.2023, me datë 05.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “NT “Abetarja”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1810/22 të datës 26.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1810/22 të datës 26.09.2023, në dispozitiv të aktvendimit ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Novobërdës-Drejtoria e Arsimit ashtu që është anuluar Urdhri përmbartimor P.nr.427/22 i datës 03.06.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim M. Musa.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, shkeljen e dispozitave të procedurës përmbartimore, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjenjës faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, të aprovoj ankesën si të

bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1810/22 të datës 26.09.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqit debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “NT “Abetarja”, me datën 03.06.2022, ka paraqitur propozimin për përmbaremore bazë të dokumenteve –Fatura nr.FSM-21-000288, e datës 01.09.2021, Fatura nr.FSM-21- 000436 e datës 10.12.2021, Fatura nr.FSM-21-000286 e datës 01.09.2021, Fatura nr.FSM-21- 000285, e datës 01.09.2021 dhe Fatura nr.FSM-21-000285 e datës 01.09.2021, duke detyruar debitorin që në emër të borxhit nga faturat e lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 496.96€ (katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent) dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbaremore që do të krijohen nga momenti i dorëzimit të propozimit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbaremore duke theksuar se vendimi i përmbaremit privat, është marrë në bazë të gjendjes faktike jo të saktë dhe jo të plotë sepse kërkesa nga dokumenti autentik nuk ka arritur asnjëherë në adresën e komunës, e debitori nuk ka dëshmi në evidencën e faturave hyrëse - faturat në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, faturat nuk janë regjistruar si të pranuar, debitori nuk ka legjitimitet pasiv në këtë procedurë e poashtu , nuk ka marrëveshje ndërmjet kreditorit - librarisë dhe komunës. Andaj gjykatës i ka propozuar që të pranohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri për lejimin e përmbaremit.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit për faktin se kreditori procedurën përmbaremore e ka iniciuar në bazë të faturave të cilat i plotësojnë kushtet ligjore sipas LPP-së, ku faturat janë origjinale dhe të elementet që duhet ti ketë një faturë,

andaj debitori ka qëllim të prolongoj procedurën. Me kërkesë që të refuzohet prapësimi i debitorit si i bazuar ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1810/22 të datës 26.09.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Novobërdës-Drejtoria e Arsimit ashtu që është anuluar Urdhri përbarimor P.nr.427/22 i datës 03.06.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Kushtrim M. Musa.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit Përbaruesi privat ka lejuar përbarimin, nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përbarimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja

faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, dhoma e shkallës së dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejtë se faturat si dokument i besueshëm, mbi bazën e së cilave është lejuar përmbarimi nuk mund të vërtetohet se janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se faturat janë dorëzuar te debitori, pasi që të njëjtat nuk janë protokolluar në zyrën e pranimi të debitorit Komuna e Novobërdës, nuk mbajnë vulën e pranimi – protokollimit, e për më tepër faturat në fjalë nuk përmbajnë as emërtimin e debitorit si në faturë, ngase në faturë figuron vetëm debitori SH.F.M.U Adreni dhe se mungon emërtimi i debitorit Komuna e Novëvërdës, andaj dhe rrjedhimisht të njëjtat nuk mund të konsiderohen si dokumente të besueshme për përmbarim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se fakti se debitori si institucion publik pranon dokumente, përfshirë në rastin konkret faturat kontestuese, si dokumente me vulë të pranimi (të protokolluar), që nënkupton se e ka pranuar faturën si të tillë dhe shërbimin e ofruar të cilën e përmban e njëjta, respektivisht prestimin sipas faturës. Andaj, që fatura të konsiderohet si pranimi i rregullt, do të duhej që debitori si palë kontraktuese, apo përfitues i shërbimeve ta pranonte faturën e rregullt me në mënyrë të rregullt nëpërmjet vulës së protokollimit.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por të njëjtat mbesin të pabazuara pasi nuk ka arritë ti argumentoj me prova juridikisht të vlefshme dhe se nuk kishin në ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarimore dhe si të tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1646/23 me datë 05.04.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija- Ymeri